REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

DEÇANI

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

STATUTI

I QENDRES KKRYESORE TË MJEKSISË FAMILJARE

DEÇAN , MARS 2017

Bazuar në nenin 11, nenin 12.2 pika d), nenin 17 pika j), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-04 (" Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28\2008),dispozitave të nenit 45 të Ligjit Nr.04\L-125 për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare nr.07.05.2013), nenit 5 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02\2015,si dhe nenit 14 pika 10) dhe 13) të statusit të Komunës të Deçanit Nr.01\V-02\2010, Kuvendi I Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më datën..... miraton :

STATUTIN

E QENDRES KRYSORE TË MJEKSIS FAMILJARE NE DEÇAN

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

1.1.Me këtë Statut rregullohet emërtimi , selia dhe veprimtaria, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, Struktura e Institucionit, trupat e Institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, koincidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë të kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare(ne vazhdim te tekstit- QKMF).

1.2. Themelues i QKMF-së është Kuvendi i Komunës së Deçanit

1.3. Bazuar ne dispozitat dhe kushtet e parapara ne nenin 40 dhe 42 te ligjit për Shëndetësi, Ligji Nr.04\L-125 dhe aktet nënligjore, fillimi i punës së QKMF-së bëhet me akt te veçantë nga Ministria e Shëndetësisë (ne vazhdim të tekstit Ministria).

1.4.QKMF në Deçan ka filluar punën me datën 01.01.1950 fillimisht si Mjekësia e Përgjithshme

Statusi i QKMF-së

Neni 2.

2.1. QKMF ka statusin e personit juridik, ne cilësinë e autoritetin e punëdhënës, kur organizohet, ofrohet dhe zbatohet kujdesi parësorë shëndetësor publik.

Neni 3

3.1.QKMF posedon më mjetet dhe pasurin e cila është pronë e Kuvendit të Komunës.

3.2. QKMF si institucion shëndetësor primar në Komunë është përvetësuese e fondit për financim të saj nga buxheti i Republikës së Kosovës, Buxheti i Komunës , bashkë pagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore si te hyra vetanake , dhuratat dhe trashëgimit e dhuruara nga qytetarët, donacionet dhe nga aktivitetet e autorizuara.

II. Emërtimi dhe selia

Neni 4

Emërtimi

4.1. Emri institucionit është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (Adem Ukëhaxhaj) në Deçan.

4.2. Shenja njohëse e QKMF-së është shenja tradicionale e mjekësisë, gjarpri më taftare më ngjyrë të kaltër

4.3. Emërtimi i QKMF-së duhet të jetë i mbishkruar në objekt në të cilin kryhet veprimtaria shëndetësorë, mësimore dhe shkencore, në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë

4.3. Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe njësit tjera organizative do të mbajnë emërtimin e QKMF-së duket shtuar njësi organizative dhe selinë e saj.

4.4. Për ndryshim e emrit e selis së QKMF-së vendos themeluesi

Neni 5

Selia

5.1. Selia e QKMF-së "Adem Ukëhaxhaj" gjendet në Rr. Dëshmorët e Kombit p.n në Deçan

Neni 6

Vula

6.1. QKMF në Deçan posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si qendër kryesore në Deçan

6.2.Vula është në formën e rrumbullakët dhe ka dimensionet prej 2.5cm

6.3. Vula duhet të përmbaj emrin e institucionit selinë dhe të jetë në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë

a).Rrethi i parë – Republika e Kosovës

b).Rrethi i dytë – Komuna e Deçanit

c).Rrethi i tretë – QKMF- Deçan.

6.4. QKMF posedon vulën Katërkëndëshe me dimensione 60-30 mm, që përmban , emërtimin ,selinë, hapësirën për evidentimin e numrit dhe datës se pranimit te dokumentit.

6.5. Për numrin e vulave mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori.

6.6.Çdo vulë ka numër identifikues.

Neni 7

Veprimtaria e QKMF

7.1. Veprimtaria e QKMF-së është ofrimi I kujdesit parësorë shëndetësore për qytetaret e Komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare ne kuadër të sistemit unik shëndetësore të Kosovës.

7.2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të Komunës tu ofrojë kujdes shëndetësorë gjithëpërfshirës, bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimit të mjekut familjar i cili do të jetë portë hyrëse për pacientet ne sistemin shëndetësorë, dhe njëherit pike referuese për specialistet konsultant në kujdesin parësorë dhe ne niveleve të tjera të kujdesit shëndetësorë..

7.3. Sipas strategjisë dhe standardeve të mjekësisë familjare synohet që një mjek familjarë duhet të ushtrojë kujdes shëndetësorë për 2000 deri 2500 banorë sipas shtrirjes territoriale gjeografike dhe organizimit të QKMF-së. Këto standarde do të jenë subjekt i revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

7.4. Kujdesi shëndetësor në QKMF zbatohet nga profesionistet të paraparë ne Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L-125, përberë nga:

* Specialisti i mjekësisë familjare;

* në mungesë të specialistit të MF-ve, specializanti në MF ose doktori i mjekësisë;

* doktori i stomatologjisë;

* infermierët familjarë;

* teknikët mjekësore.

7.5. Kujdesi shëndetësorë në QKMF përkrahet nga specialistët konsultant ekzistues pranë QKMF-së si :

* specialisti i stomatologjisë;

* pediatri;

* gjinekologu-obstetër dhe;

*specialisti ekzistues të lëmive tjera;

* infermierët, mamitë si dhe teknikët mjekësore te parapara ne Ligjin për Shëndetësi të Kosovës.

7.6. Specialistët konsultant ekzistues dhe atë: specialist i sëmundjeve të brendshme, do tu jepet mundësia që të ndjekin Modulin orientues në:

Mjekësinë familjare. Pas kësaj ata do të mund të përfundojnë karrierën ne Ekipet e Mjekësisë Familjare.

7.7. Specialistët konsultant ekzistues të tjerë, dhe ata nga neni 7.6. të cilët nuk do të ndjekin këtë Program do të vazhdojnë punën e tyre deri në pensionim me ç 'rast ky profil punëtorit shëndetësor shuhet në QKMF.

Neni 8

8.1. QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

a.) përparimi, parandalimi, mjekimi, shërimi dhe rehabilitimi që ka të bëjë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet;

b.) edukimi shëndetësor imunizimi dhe vaksinimi;

c.) përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi elementar shëndetësor përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;

d.)promovimi i shëndetit oral dhe kujdesi themelor stomatologjik;

e.) kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi;

f.)rehabilitimin bazuar në bashkësi;

g.) kujdesi shëndetësor riprodhues që përfshin kujdesin shëndetësore gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave, si dhe metodat e planifikimit familjarë;

h.) zbulimi i hershem i sëmundjeve ngjitëse;

i) kryerja e shërbimeve specialistike dhe diagnostike, analizave laboratorike dhe rëntgenologjike në kujdesin parësor shëndetësor.

IV. Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi.

Neni 9

9.1. QKMF në Deçan është institucion i cili benë pjesë në Rrjetin e Institucioneve Shëndetësore Publike të Ministrisë.

9.2. QKMF kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e Komunës së Deçanit sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësi neni 12, me këtë Statut dhe dispozitave tjera Ligjore.

9.3. Për nënshkrimin e Kontratave me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet (kapitale) të QKMF, QKMF duhet të këtë se pari aprovimin e themeluesit.

9.4. Në rast të nënshkrimit të kontratave nga paragrafi 9.3. QKMF paraqitet si subjekt i pavarur juridik dhe afarist në Ligjin për Prokurim Publik dhe ligjeve të nxjerra nga Ministrit e Financave.

9.5. Për përgjithësitë e marra financiare QKMF përgjigjet me tërë pasurinë e saj.

9.6. Themeluesi i QKMF-së përgjigjet në mënyrë solidare për obligimet e saj.

9.7. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhirollogarisë unike të QKMF-së pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

Neni 10

10.1. Drejtori i QKMF-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF-së, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti.

IV. Struktura e Institucionit

Neni 11

11.1. QKMF për ta realizuar funksionin e mbrojtjes shëndetësore për qytetaret e vet është organizuar nëpërmjet :

a.) Departamenti i mjekësisë Familjare

Departamenti i mjekësisë Familjare përbehet nga :

- Sektori i mjekësisë Familjare
- Sektori i shëndetit Publik
- Njësia e SISH-it
- Njësia e vakcimit
- Sektori i shëndetit oral
- Sektori i Kujdesit Emergjent
- Sektori Konsultativ

- Njësia e Pediatrisë
- Njësia e gjinekologjisë dhe maternitetit
- Njësia e Internosë
- Njësia e Pnemofizës
- Sektori i Diagnostikës
- Kabineti Radiologjik dhe
- Laboratori

b.) **Departamenti i Administratës**

Ky departament varësisht nga madhësia e QKMF-së mund të organizohet ne njësi të veçanta apo zyra :

- Zyra e personelit
- Zyra Juridike
- Zyra për Buxhet dhe Financa
- Zyra për shërbime teknike

c.) Departamenti i Maternitetit

* Departamenti i Maternitetit është njësia organizative e QKMF-ës, hapja e së cilës lejohet vetëm me vendim të veçant nga Ministria e Shëndetësisë.

* Materniteti duhet të përmbush kushtet e përgjithshme dhe standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

* Me punën e Maternitetit udhëheq shefi i Maternitetit.

d.) Barnatorja Qendrore e QKMF-së

* Barnatorja është njësia organizative e QKMF-së e cila themelohet dhe funksionon sipas Ligjeve dhe akteve nënligjore që e rregullojnë aktivitetin farmaceutik.

* Në barnatoret pranë QKM-së mund të shpërndahen vetëm barnat nga Lista esenciale e Barërave, e lejuar nga Ministria , dhe të përshkruara në recetat unike, nga Mjekët Njësisë së Mjekësisë Familjare.

* Çdo tregtim me barna komerciale në barnatoret brenda QKMF-së është i ndaluar dhe sanksionohet sipas ligjeve në fuqi.

* Me barnatoren udhëheq shefi i barnatores.

11.2. Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Ambulanca Shëndetësore në kuadër të QKMF-së në Deçan , përben Rrjetin e Institucioneve të KPSH në Komunën e Deçanit. Ky rrjet i institucioneve shëndetësore do te jetë objekt i revidimit periodik që do te ndermiret nga KK i Deçanit dhe Ministria.

Sistemi i Informimit Shëndetësorë në QKMF

Neni 12

12.1. QKMF zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë Lëmi.

12.2. Për qëllime të sistemit të informimit Shëndetësor, Ministria në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi (DKSH) dhe QKMF do të zhvillojë një sistem unik të kodeve për të gjitha QKMF-të dhe departamentet e saj.

12.3. Sistemin e informimit shëndetësor në QKMF e përbejnë :

* Sistemi i evidencave me të cilin rregullohet evidentimi i të dhënave;

* Sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre dhe publikimi.

12.4. QKMF bënë mbledhjen, evidentimin, vendosjen e të dhënave statistikore në sistemin e informimit shëndetësor (SISH) në programin kompjuterik të Ministrisë i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.

12.5. QKMF pas mbledhjes, evidentimit dhe vendosjes së të dhënave statistikore, është e obliguar që përmes raporteve të caktuara periodike dhe në formular të përcaktuara nga Ministria, të dërgojë ato në Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe përmes Zyrës të Autoritetit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë në Pejë, në Departamentin e Shëndetësisë Publike në Regjionin e Pejës.

12.6. Çdo profesionist shëndetësor gjatë raportimit duhet të siguroj fshehtësinë profesionale, duke mos cenuar të drejtat e pacientit përveç rasteve të rregulluara me ligj.

V. Udhëheqja dhe Trupat QKMF

Neni 13

Këshilli Drejtues

13.1. Këshilli drejtues drejton aktivitetet e QKMF-së, nën udhëheqjen e Drejtorit Ekzekutiv

Përbërja, Kompetencat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

Neni 14

14.1. Këshilli drejtues përbëhet nga pesë (5) anëtar,

a.) Drejtori Ekzekutiv i QKMF-së, i cili e kryeson Këshillin;

b.) Kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;

c.)Kryeinfermieri-rja e QKMF-së;

d.) Kryeshefi i Departamentit të Administratës;

e.) Përfaqësuesi i Këshillit profesional.

14.2. Mandati i anëtareve të këshillit zgjatë sa edhe kontrata e tyre. Ky mandat mund të përfundoj edhe më parë në rast :

a.) Të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në QKMF,

b.) Të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit drejtues,

c.) Nëse brenda vitit mungon tre herë pa arsye në mbledhjen e këshillit,

d. Nëse tregon mosrespektim ndaj obligimeve të punës.

Neni 15

15.1. Anëtareve të Këshillit Drejtues mund të ju përfundoj mandati edhe në këto raste :

a.) Nëse nuk iu përmbahen politikave të themeluesit;

b.) Nëse marrin pjesë në marrjen e vendimeve joligjore ose vendimeve të cilat i shkaktojnë dëm QKMF-së.

Neni 16

16.1. Këshilli drejtues kryen punë të parapara me këtë statut dhe vendos për:

* Veprimtarinë e QKMF-së dhe vërteton politikën punuese të QKMF-së.

* Propozon ndryshimet e statutit të QKMF-së,(te cilat i aprovon themeluesi),

* Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF-së dhe i raporton Ministrisë përmes drejtorisë Komunale për shëndetësi dhe zyrave të Autoritetit shëndetësor të Ministrisë (ZASHMSH),

* Vendosë për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;

* Bien programin e punës dhe planin financa;

* Bien rregullore për organizmin e punës të QKMF dhe akteve tjera në përputhshmëri me Ligjin dhe këtë Statut.

* Bien planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional, brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e Ministrisë,

* Aprovon çmimet e shërbimeve shëndetësore të cilat i ofron QKMF e të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e Ministrisë,

* bien planin e furnizimit te QKMF dhe vendos për dhënien ne shfrytëzim te lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënien në shfrytëzim të mjeteve të veçanta

* Bien planin mbi zhvillim e Vazhdueshëm profesional të Kuadrit medicional dhe bashkëpunëtoreve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij.

* Bien planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë,

* Vendosë për mbarëvajtjen e punëve

* Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese

* Vendosë për sigurimin e pasurisë së QKMF, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit

* Propozon ndërtimin dhe adoptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar ne politiken shëndetësore

* Shqyrton njoftimet mbi mbikëqyrjen e raporteve te përkohshme mbi punën profesionale

* Kryen dhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe akte tjera normative të QKMF-së.

Neni 17

17.1 Këshilli drejtues i QKMF-së i kryen detyrat brenda përgjegjësive të veta në mbledhje

17.2 Këshilli drejtues merr vendim kur janë prezent më tepër se gjysma e anëtareve

17.3 Këshilli drejtues merr vendim me shumicë të votave të anëtareve prezent.

17.4 Në mbledhjen e Këshillit drejtues mbahet procesverbali të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në mbledhjen vijuese

17.5 Këshilli drejtues aprovon rregulloren e punës së QKMF-së në të cilën rregullohen me detalisht çështjet në lëmine e punës të cilat nuk janë të rregulluara me ligj dhe këtë statut.

Drejtori i Qendrës Kryesore te Mjekësisë Familjare

Neni 18

18.1 Qendrën Kryesore te Mjekësisë Familjare në Deçan e udhëheq Drejtori

18.1 Drejtori është përgjegjës për afarizmin, prezanton dhe përfaqëson QKMF-në dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë

18.2 Drejtori udhëheqë punën profesionale të QKMF-së në bashkëpunim me Këshillin Drejtues ,Këshillin profesional dhe sipas nevojës me kolegjiumit profesionale të njësive organizative të nenit 11 të këtij statuti.

Procedurat për Emërimin dhe Shkarkimin e Drejtorit

Neni 19

19.1. Drejtori QKMF-së zgjidhet në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/ L-149, Ligjin për Shëndetësi Nr.04/L-125, Udhëzimin Administrativ 02/2015 dhe dispozitave te parapara me këtë Statut.

19.2. Drejtorin e zgjedh Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-DSHMS, në periudhën prej 4 (katër) vjetësh, me mundësi të rizgjedhjes duke respektuar procedurat e konkursit të hapur publik sipas ligjit në fuqi.

19.3. Drejtori i QKMF duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve dhe normave statutare në fuqi.

19.4. Të jetë Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare;

19.5. Të jetë mjek-profilet sipas sektorëve (te parapara ne dispozitat e nenin 7 te këtij Statuti)

19.6. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjeksisë familjare ose kandidatët me shkollim professional në fushën e menaxhimit shëndetsorë;

19.7. Kandidati për Drejtor duhet ti ketë 5 (pesë) vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3 (tre) vjet përvojë pune në dispozitat menaxheriale.

19.8. Vendimin për publikimin e konkursit për Drejtor të QKMF-së e merr DSHMS.

Neni 20

201 Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të QKMF-së e merr themeluesi

20.2 Kuvendi Komunal autorizon Drejtorinë Komunale për Shëndetësi të shpallë konkursin për Drejtor të QKMF-së

20.3 Mandati i drejtorit të QKMF-së zgjatë katër (4) vite

20.4 Drejtori i QKMF-së nuk mund të zgjidhet më tepër se dy mandate radhazi

Kompetencat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit të QKMF-së

Neni 21

21.1 Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së, si dhe për punën profesionale të QKMF-së, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe akteve tjera ligjore.

21.2 Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për përkujdesjen eficiente dhe efektive, të shëndetësisë primare publike, për të gjithë banorët e Komunës së Deçanit, dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë.

- Në pajtim me politikën shëndetësore; Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë Komunal për Shëndetësi Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF-së për vitin vijues.
- Drejtori është përgjegjës për implementimin e planit të burimeve njerëzore sipas nenit 15 pika 7
- Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të DKSH zbaton buxhetin e QKMF-së
- Të jetë përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF
- Te zhvilloj marrëdhënie të mira me donatorët, dhe OJQ-të dhe me partneret për zbatimin e tyre.
- Të vendos mekanizma të sigurimit të cilësisë në objektet e KPSH të Komunës
- Të mundësoj zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së
- Të jap kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së sipas standardeve të pranuara dhe të siguroj mbledhjen e informative.

- Të avancoj punën kipore.

21.3. Programi i punës së QKMF-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shë sistemit shëndesor të nxjerrura nga Ministria.

21.4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen :

* plani vjetor i punës

* organizimi dhe udhëheqja

* burimet njerzore

* plani financiar

* raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare

21.5. Për kryerjen e punëve të tij drejtori i QKMF-së i pergjigjet Drejtorit Komunal për shëndetësi

21.6. Proedurën për ndërmarrjen e masave siq janë vërejtja verbale, vërejtja me shkrim, apo masa tjera administrative ndaj Drejtorit të QKMF-së mund ti inicon apo ndërmarr, Këshilli mbikëqyrës, Kuvendi i Komunës përmes Drejtorisë Komunale të shëndetësisë apo (bazuar në Ligjin për Shëndetësi nr.04/L-125 dhe Udhëzimin Administrativ nr.02/2015) Ministria e Shëndetësisë përmes Drejtorit të Autoritetit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë ndërsa procedurën për shkarkimin e Drejtorit të QKMF-së mund ta ndërmerr Drejtoria Komunale për shëndetësi apo Kuvendi i Komunës, kur konstatohet shkelja e procedurave në dhënien e kujdesit shëndetësor sipas Ligjit të Shëndetësisë dhe akteve tjera nënligjore.

Neni 22

22.1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve të Këshillit Drejtues që të terhjek vëmendjen.

* Në aktet e propozuara që janë në kundërshtim me ligjet relevante gjegjësisht aktet e përgjithshme të QKMF-së.

* Që akti i propozuar është në kundërshtim me programin e punës së QKMF-së

* Që akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

Neni23

Mandati i Drejtorit te QKMF-së përfundon kur përmbushen kushtet e përcaktuara ne Dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës Nr.03/L-149

Trupat e QKMF-së

Neni 24

24.1. Për përmbushjen detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues përmes Drejtorit të QKMF-së formon Trupa profesionale pranë QKMF-së, siç janë :

Këshilli profesional, Kolegji profesional

Komisioni Disiplinor i QKMF, Komisioni për ankesa i QKMF,

Komiteti për sigurimin e cilësisë së shërbimeve ,

Komiteti për zhvillim të vazhdueshëm profesional, Komisioni Etiko-Profesional

24.2. Anëtaret e trupave profesionale emërohen nga Drejtori.

24.3. Këshilli Drejtues përmes Drejtorit të QKMF-së sipas nevojës mund të formoj edhe trupa tjerë profesional pranë QKMF-së.

Këshilli profesional

Neni 25

25.1. Këshilli profesional është trup këshillëdhënës për drejtorin e QKMF-së

25.2. Këshilli profesional përbëhet nga Krye- shefat e Departamenteve nga Neni 11 i këtij Statuti, Shefat e Sektorëve, si dhe Materniteti, Barnatores, QKMF-ve dhe kryeinfermieri-ja e QKMF-së.

25.3. Kryetar i Këshillit profesional sipas Detyrës zyrtare është Kryeshefi i departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së.

25.4. Këshilli profesional e nxjerrë rregullore e punës për punën e Këshillit.

Kryetari i Këshillit Profesional

Neni 26

26.1. Kryetari i Këshillit Profesional kryen këto prunë :

a) përgatitë, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit Profesional;

b.) verifikon rendin e ditës së mbledhjes.

26.2. Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thirre mbledhjen brenda 3 (tre) dite pasi të këtë kërkuar Drejtori i QKMF-së ose Krye-shefi i Departamentit të mjekësisë Familjare.

Neni 27

27.1. Këshilli Profesionale i QKMF-së përveç detyrave të parapara me Ligj i kryen edhe këto detyra :

* Diskuton dhe vendosë për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostikuese dhe terapeutike,

* Propozon Këshillit Drejtues dhe Drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë,

* Propozon strukturën e mbikëqyrjes se brendshme lidhur me punën e punëtoreve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale,

* Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe propozon drejtorit dërgimin e punëtoreve shëndetësore në përsosje profesionale dhe shkencore,

* Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera të cilat drejtori ia parashtroj Këshillit Profesional.

Kolegji Profesional

Neni 28

28.1. Me qëllim të çështjeve në lëmine e punës profesionale në çdo Sektor nga neni 11 i këij Statuti themelohet Kolegji Profesional.

28.2. Kolegjin Profesional e përbejnë :

* Shefi i sektorit sipas nenit 11 të këtij Statuti,

* Kryeinfermieri-ja e sektorit sipas nenit 11 të këtij Statuti,

* Punëtorët profesional të atij Sektori.

28.3. Kolegji Profesional i kryen këto punë :

* Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në Sektor/njësi, merr qëndrim dhe propozim lidhur me zgjedhjen e këtyre çështjeve.

* Shqyrton dhe përmes shefit të Sektorit i propozon Këshillit Profesional, për nevojën dhe arsyeshmërinë profesionale të implementimit të metodave të reja diagnostike dhe terapeutike,

* Përmes shefit të sektorit, propozon Këshillit Profesional dhe Drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizmit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

28.4. Udhëheqësi i Sektorit sipas nenit 11 të këtij Statuti është edhe kryetar i kolegjit profesional dhe i përgjigjet Kryeshefit të Departamentit të mjekësisë familjare sipas këtij Statuti.

Këshilli Etik

Neni 29

29.1. Këshilli Etik është trup i cili siguron kryerjen e veprimtarisë QKMF-së mbi bazat e etikës dhe deontologjisë.

29.2. anëtarët e Këshillit Etik i emëron Këshilli Drejtues.

29.3. Këshilli Etik përbehet nga 5 anëtarë :

* Katër përfaqësues të QKMF-së (3 nga profesioni mjekësor dhe një nga profesioni jo-mjekësor)

* Një person i cili është i profesionit jo- mjekësor nga Shoqëria Civile, i / e është individ i/e spikatur për punën shkencore ose shoqërore.

* përbërja e këshillit ne aspektin gjinor duhet te përmbushe Kriteret e përcaktuara ne Ligjin për Barazi Gjinore, Ligji Nr.05/L-020.

Neni 30

30.1. Këshilli etik i QKMF-së i kryen këto punë:

* Përcjell implementimin e veprimtarive etike dhe deontologjike në lëmin e shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në QKMF.

* Miraton kërkime shkencore në QKMF sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë lëmi,

* Shqyrton edhe çështje të tjera etike lidhur me veprimtarinë e QKMF-së

30.2. Këshilli etik bien rregulloren e punës së Këshillit.

30.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjera përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF-së, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte tjera Ministria e Shëndetësisë.

Organizimi Sindikal

Neni 31

31.1. Në QKMF mund të organizohet Organizata Sindikale ku punëtoret me antarsimin e tyre vullnetar do t'i realizojnë të drejtat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare.

31.2. Në rast greve të punëtoreve, në QKMF duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Neni 32

32.1. Në kuadër të QKMF-së organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtoreve shëndetësor, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shëndetësi dhe akteve tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

32.2. Aktivitetet e Zhvillimit të vazhdueshëm Profesional (ZHVP), të Edukimi Specialistik Pasdiplomik (ESP) dhe atij të Edukimit Themelor (ETH), për punëtoret shëndetësorë ne KPSH, mbahen në QZHMF, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Qendrën për Edukim të vazhdueshëm Infermierik, Qendrën e trajnimit të mjekësisë familjare dhe institutin Kombëtar te Shëndetësisë Publike të Kosovës.

32.3. Për mbajtjen e aktivitetit nga Neni 30.2 përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në programet e Mjekësisë Familjare dhe të infermierisë Familjare të përcaktuar nga Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik, pran Ministrisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me QKMF, të cilat kanë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale.

32.4. Ministria e bazuar në Udhëzim administrative 02/2015 Zhvillimi I Vazhdueshëm Profesional, Edukimi Specialistik Pasdiplomik, me propozim të Komiteteve specialistike të lëmive përkatëse emëron Mentorët klinik për specializantet e Mjekësisë Familjare.

32.5. Titujt profesional dhe akademik do të njihen me sistematizimin e vendeve të punës në QKMF, dhe njëherësh do të gradohen sipas Ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këtë.

32.6. Financimi i ZHVP të punëtoreve bëhet nga buxheti i QKMF dhe burimet tjera të disponueshme.

VIII. Mbikëqyrja e QKMF

Neni 33

33.1. QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale që sigurohet përmes DKSH dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

33.2. Mbikëqyrja në QKMF e bënë Këshilli Mbikëqyrës.

33.3. Formimi, përbërja dhe funksionimi i Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me udhëzim administrativ të nxjerrur nga Ministria.

33.4. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren mbi mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e bien Këshilli Drejtues i QKMF-së.

33.5 Mbikëqyrja dhe monitorimi i QKMF-së përfshinë:

* Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të shëndetit parësor lidhur me infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve,

* Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria,

* Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve të procedurave financiare lidhur me menaxhimin e fondit te alokuar e paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e financave, dhe rregullat e Prokurimit.

33.6. Në qoftëse hasen vështirësi ne realizimin e detyrave ë QKMF-së Ligjit për shëndetësi si dhe detyrave dhe obligimeve që përcaktohen në këtë statut, DKSH do të ndërmerr masat për eliminimin e tyre, e nëse edhe kjo drejtori nuk mund të sanoj situatën në afat prej 4 jave nga vërejtjet e bëra nga Zyra e Autoritetit Shëndetësorë të Ministrisë së Shëndetësisë, atëherë Ministria e Shëndetësisë do ë ndërmerr masat e duhura administrative për eliminimin e parregullsive në bazë të ligjit për Shëndetësi.

IX. Aktet e përgjithshme

Neni 34

34.1. Aktet e përgjithshme të QKMF-së janë : Statuti, Rregulloret e Punës dhe Vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

Neni 35

35.1. Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues nxjerr këto akte të përgjithshme të QKMF-së :

1. Rregulloren mbi organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;

2. Rregulloren për punë

3. Rregulloren për gradim, pagesa dhe të drejta tjera materiale të punëtoreve nëse me akte tjera nuk është rregulluar ndryshe;

4. Rregulloren për mbrojtjen në punë;

5. Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit;

6. Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;

7. Rregulloren për rendin shtëpiak.

8. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;

9. Rregulloren për parandalimin e infeksioneve;

10. Rregulloren për mbarëvajtjen e punës në QKMF.

11. Rregulloren për disipline.

X. Pronësia, Buxheti dhe Financat

Pronësia

Neni 36

36.1. Pasurinë e QKMF-së e përbejnë gjërat, të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat kanë qenë të evidentuara si pronë shoqërore, me të cilat QKMF ka pasë të drejtë t'i posedojë në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për shëndetësi të Kosovës.

36.2. Po ashtu pasurinë e QKMF-së e përbejnë gjërat, të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat pas hyrjes në fuqi të rregullores 2000/45, të Ligjit për Shëndetësisë të Kosovës, QKMF i ka fituar me punë ose nga të hyrat të tjera.

Buxheti

Neni 37

37.1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF-së administrohen në më transparente në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.

37.2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF-së duhet të përfshijnë tërë shpenzimet operative të Njësive punuese.

37.3. Prokurimi i QKMF bëhet konform rregullave të ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës.

37.4. QKMF ia prezanton buxhetin vjetor Drejtorisë Komunale për Shëndetësi për miratim.

37.5. Drejtori mund të kërkoj Auditim të jashtëm që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Financimi

Neni 38

38.1. QKMF shfrytëzon burimet financiare konform Ligjit për Shëndetësi të Kosovës , nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet tjera të parapara me Ligjet përkatëse dhe me dispozitat e këtij Statuti .

38.2. Bashkë pagesa për shërbimet e ofruara në QKMF, si burim i financimit të aktiviteteve të QKMF-së, do të behet në bazë të çmimorës së aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Kuvendi Komunal.

38.3. QKMF do të nxjerrë akte të veçanta të detajuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme që do të jenë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria.

XI. Transparenca në punë

Neni 39

39.1. Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe kryerja e veprimtarisë së QKMF-së janë publike dhe transparente ndaj personave juridik dhe fizik përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

Neni 40

40.1. Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë si dhe shiqimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit mund te jep vetëm Drejtori punëtori i QKMF-së të cilën ai e autorizon.

Neni 41

41.1. Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shiqim personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm reputacionit dhe interesit afarist të QKMF-së.

Neni 42

42.1. Sekret afarist konsiderohen :

I. Dokumentet të cilat Drejtori i vlerëson si sekret afarist :

II. Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si e tillë;

III. Masat dhe mënyra e veprimit në rast të krijimit të situatave të jashtëzakonshme;

IV. Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko-teknike të punëtoreve dhe pasurisë së institucionit;

V. Si dhe të dhënat të tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e institucionit dhe themeluesit ë tij;

XIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 43

43.1. Aktet e përgjithshme nga Neni 33 dhe 34 i këtij Statuti do të konsolidohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Statuti.

Neni 44

44.1. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF-së 01.NR i datës 19.01.2007.

Neni 45

45.1. Ky statut mund të ndryshohet me procedurë të njëjte me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Neni 46

46.1. Ky Statut hynë në fuqi pas aprovimit nga Themeluesi / Kuvendi Komunal në Deçan / dhe pas Konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

01.Nr.

Deçan, dt.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit :

Jashar Dobraj

_____